

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 24 SHKURT 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kjo seancë përkon me një moment shumë të ri, të veçantë dhe të pamenduar disa ditë më parë për të gjithë botën dhe globin. Pa diskutim që është një situatë e re; është më e keqja, më e pamenduara dhe besoj se sot paqja ndihet më e kërcënuar se kurrë më parë që pas Luftës së Dytë Botërore. Natyrshëm, Shqipëria, tashmë anëtare e NATO-s, jo më një vend si më parë, nuk i ka larg këto konflikte. Për një vend anëtar të NATO-s këto konflikte konsiderohen konflikte që janë te dera e saj. Si e tillë, kërkohet një sjellje tjetër, kërkohet një qëndrim tjetër, një seriozitet tjetër dhe sjellje e ndryshme e shtetit. Pa diskutim, është e paimagjinueshme që dita e sotme parlamentare të mos hapej me informimin nga ana e Kryeministrit për çështjen, për pozicionimin e Shqipërisë dhe të qeverisë së Shqipërisë, pa diskutim më tej të gjithë do të prisnim me kënaqësi e durim, por edhe me përgjegjësi të lartë të dëgjonim fill pas tij ministren e Punëve të Jashtme, e cila nuk duhej të kishte objekt t'i replikonte kolegët tanë, siç ishte kolegu Shehu, por duhej të raportonte me seriozitet për çështjen, do të duhej të vazhdonte ministri i Mbrojtjes, pse jo edhe ministri i Brendshëm, pasi jemi vend i NATO-s, që do të thotë se Rusia dhe NATO-ja ndodhen ballë për ballë njëra-tjetrës. Por asnjëra nga këto nuk ndodhi, pasi të tjera halle, shqetësime dhe prioritete ka qeveria. Ka atë prioritetin, siç thotë populli: "Gjuha shkon ku dhemb dhëmbi"; kanë hallin e inceneratorëve, si t'i justifikojnë, si t'i minimizojnë, si t'i bëjnë sikur nuk ekzistojnë. Nuk sillen si shtetarë. E kundërta ndodhi me Presidentin e Republikës, i cili, në orën 17:30, sipas njoftimit zyrtar, thërret sërish një mbledhje tjetër urgjente të Këshillit të Sigurisë, natyrshëm, siç do të sillej çdo shtetar serioz.

Megjithatë, këtu ndahen shtetarët nga klientët dhe përdoruesit e inceneratorëve. Meqenëse kjo temë qe kaq për zemër, pavarësisht thirrjeve për t'iu përmbajtur rendit të ditës, të cilat nuk funksionojnë, pasi kjo çështje dominoi dhe qeveria e mori vetë përsipër ta çonte këtu këtë rend dite, po përqendrohëm pak minuta te kjo çështje. Dje kemi parë një Kryeministër të çartur, ashtu siç është edhe standardi i tij politik, etik dhe psikik, që na foli për një revolucion. Ka folur për revolucionin më të zi që Shqipëria ka parë ndonjëherë, revolucionin e pandershmërisë, të paligjshmërisë, të mbrojtjes me gjoks, ballë për ballë, të korrupsionit, të krenarisë së punës dhe të bashkëpunimit të tij me ministrat që ndodhen mbrapa hekurave, gjithashtu revolucionin e zi kundër shëndetit, kundër mjedisit, sepse asnjë shqiptar, që ka mend në kokë, nuk mund të pranojë të kthejë përmbys piramidën e trajtimit të mbeturinave, të cilën e kam ngritur vite më parë, që në 2017-n e largët, kur një ish-ministër foli këtu një herë të vetme dhe na akuzoi për miopi, sepse e shikonim trajtimin e mbeturinave, ashtu siç e bëjnë Europa dhe vendet e përparuara, që është në të mirë të shëndetit dhe të mjedisit. Por ky revolucionar i zi, Kryeministri, tha se revolucionin e tij me kokëposhtë ishte ai që u duhej shqiptarëve. Komente të tjera për këtë nuk meritojnë.

Të gjithë këtu po bërtasin, për fat të keq, edhe ata që kanë për detyrë të jenë rojtarë të ligjit, për ligjshmërinë, pra çdo gjë ka qenë e ligjshme, e saktë dhe qeveria ka vepruar më së miri. Po pse janë hapur ato procedura atje, një proces i madh hetimor nga SPAK-u?! Procedura në veprime të ligjshme dhe të rregullta! Ne e dimë që SPAK-u ka zell të madh të mbyllë çështje, si e hapi këtë çështje, nëse ka

funksionuar ligjshmëria?! Pra, është marrëzi dhe turp që kjo thuhet edhe nga njerëz të ligjit sot në sallën e parlamentit! Shkojmë më tutje. Kemi dëgjuar këtu që thonë: “Shqipëria është më e pastër”. Mirë që duan të tallen me veten e tyre, është e drejta tyre, por nuk mund të tallen në sallën e parlamentit. Kjo Shqipëria e pastër, pas 8 vjetëve që janë në pushtet, a ishte mjegulla toksike që pushtoi Fierin; a u bë sërish në nëntorin e këtij viti aksioni vullnetar: “Të pastrojmë Shqipërinë”? Po ç’janë këto aksione vullnetare pas 8-9 vjetësh, ndërkohë që u shpenzuakan qindra milionë euro për inceneratorët?! Nuk ishte vera e vitit të kaluar, ku e gjithë zona bregdetare u mbyt me mbeturina, u asfiksua?! Ku është “Shqipëria më e pastër?!” Mendja e cilit të marrë e thotë këtë gjë?! Rreshtova fakte shumë të rënda. Le të dalë njeri e të thotë se unë po gënjej; të më thotë se njëri nga këto fakte nuk është i vërtetë; të më thotë se është një Shqipëri më e pastër pas 8 vjetësh! Në aksionin e parë të vitit 2013 “Shqipëria më e pastër” dolëm me kuç e me maç që ta pastronim Shqipërinë, por jemi po tek i njëjti aksion vullnetar, pra jemi tek e njëjta gjë, ndërkohë që milionat vërviten nga të gjitha anët. Shkojmë më tutje, te çështja themelore: shpërdorimi dhe grabitja. Këtu e quajtmë “ aferë”. Ky revolucionari i zi, Kryeministri, u ofendua se e quajtmë “ aferë”.

Ka të drejtë, nuk duhet të quhet “ aferë”. Kjo është hajdutëria më e madhe e shekullit, dhe ai ka të drejtë, sepse duhet të përdorim terma shqip. Po, hajdutëria më e madhe e shekullit! Si është hajdutëri, a është e provuar? Po, me dosje në SPAK, është bërë publike, i kanë me emra dhe mbiemra. Pse nuk guxojnë të flasin për të gjitha ato çifte, burra e grua, që u qarkullojnë nga 600-700 mijë euro për t’i kaluar në llogaritë e tyre? Janë aty, me emra dhe mbiemra. Një pjesë të skemës më është dhënë mundësia ta denoncoj publikisht në emër të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Ja ku i kam! Kush e ka kryer këtë veprimtari? Kujt t’ia kërkojmë? Këta e kanë kryer. Kanë ikur miliona pa fund. Këta bëjnë be për këta inceneratorë (le të thonë kur nuk është e vërtetë), por një qeveri financon një procedurë që nuk ekziston gjëkund në ligj! Kjo është rregullshmëria?! Ua thonë ishministrat e tyre. Ka thënë të vërtetën ish-ministri, sepse kam qenë edhe vetë në diskutimet e brendshme parlamentare që ashtu ishte, pra që financonet një procedurë që nuk ekziston në ligj. Kjo qenka në rregull?! Ky është ligji?! Për këtë rrahin gjoksin që i zbatojnë ligjet më së miri? Ecim më tej. Këtu, në këtë sallë, në vitin 2015 kemi miratuar ligjin e ri për pushtetin lokal në lidhje me reformën territoriale. Këta kanë një kryetar bashkie që rrëmben të gjitha kompetencat e këshillit bashkiak, e privatizon, e fut në xhep, e shkel ligjin ditën për ditë. Për këtë krenohen këta dhe i bien gjoksit?! Për këtë u gëzuan që u mbushën mendjen shqiptarëve që janë në rregull? Është e vërtetë kjo? Po, është atje në SPAK e vërteta. Le të thonë që nuk ka ndodhur. Jo vetëm që vuri firmën kryetari i Bashkisë së Tiranës, por bëri edhe kontratën, i mbaroi të gjitha dhe u bazua në një vendim që nuk kishte ndodhur, nuk ishte marrë akoma. Nuk besoj të na e fyeri inteligjencën në këtë farë feje që ta mbronin edhe këtë gjë. Jo, se paturpësia nuk ka kufi! Ka edhe një gjë tjetër.

Meqenëse flasin në emër të qytetarëve (qytetarët janë shumë të lumtur dhe të gëzuar), a i respektojnë këta qytetarët? Jo, jo, këta i dhunojnë qytetarët. Tri herë e ka ndërruar inceneratori i Fierit vendndodhjen e tij, me të njëjtat letra, ishte i vlefshëm në Mbyet, Portëz, pastaj u pllakos në Mbrostar në tokë buke. U dhunua qytetarët, nuk u pyetën. Që nuk u pyetën qytetarët, ka dokumente. Në atë kohë u jam përgjigjur qytetarëve, në cilësinë e ministrit të Drejtësisë, duke i mbështetur për dëgjuesën e tyre dhe konsultimin e detyruar. Nuk u krye kurrë. E, pra, të mos flasin më në emër të qytetarëve. T’u vijë zor kur i zënë qytetarët me gojë. Ata qytetarët atje nuk janë inferiorë, në raport me këta që janë këtu mbrapa, janë të barabartë dhe të drejtën për jetën, shëndetin dhe për pronën e tyre e kanë njëllë. Kështu i kanë dhunuar qytetarët. E fundit, meqë këta do të blinin e do të shisnin energjinë dhe atje do të bëhej batërdia, një ent shtetëror, siç është ERE-ja, nuk i licenoi dhe është në gjyq me inceneratorin e Elbasanit, i cili përdor paratë e shtetit; me paratë e shtetit është bërë. E, pra, shteti vihet kundër shtetit në gjyq; vetëm këta mund ta bëjnë këtë gjë. Kjo është hajdutëri e madhe, jo aferë, ka të drejtë Edi Rama; kjo është hajdutëria më e madhe e inceneratorëve që nuk ka alibi që e shpëton.

